



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit

| | |
|----------|--|
| Data | |
| Nr. Prot | |

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIM

PËR PROGRAMIN E EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE SENSIBILIZIMIT TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETARIN E BASHKISË HIMARË TË DATË 4 GUSHT 2024

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “g” dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Drejtoria e Komunikimit ka përfunduar programin për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve.

I. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Programi për edukimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë është një plan i cili përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve në këtë bashki. Ky program përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren në realizimin e objektivave, gjithashtu reflekton punën dhe angazhimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për edukimin zgjedhor të shtetasve, në përmbushje të detyrës institucionale për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuar, ku edukimi dhe informimi i zgjedhësve është ndër komponentët kryesorë garantues për arritjen e standardeve të synuara.

Programi për Informimin e zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme në Bashkinë Himarë, është i ndarë në 6 pjesë dhe përfshin të gjithë zgjedhësit, duke i informuar ato për aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor, për listën e zgjedhësve, për procedurat e identifikimit elektronik, mënyrën e votimit, veprat penale që prekin zgjedhjet, sensibilizimin e grave, të rinjve votues për herë të parë, plotësimi korrekt i fletës së votimit.

Të gjitha të dhënat personale të zgjedhësve do të ruhen në zbatim të Ligjit 9887 datë 10.03.2008, kreu II, neni 5 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Zbatimi i programeve të ndryshme për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, në një periudhë të përcaktuar kohe është një proces kompleks, suksesi i të cilit ndërvaret edhe nga bashkëpunimi me aktorë të tjerë që kanë interes dhe do të kontribuojnë në këtë fushë.

Ky program përmban 6 (gjashtë) objektiva kryesorë, të ndara si më poshtë:

Pjesa e parë: Informimi, sensibilizimi dhe edukimi i zgjedhësve për listën e zgjedhësve. Pas daljes së dekretit nga Presidenti i Republikës për mbajtjen e zgjedhjeve në Bashkinë Himarë, do të shpërndahet informacioni për zgjedhësit për datën e zgjedhjeve, listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.

Pjesa e dytë: Ndërgjegjësimin e zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor, zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara, ku si qëllim ka të informojë zgjedhësit dhe subjektet zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, si dhe parandalimi i tyre.

Pjesa e tretë: Sensibilizimi i grupeve vulnerabël, të rinjve, kryesisht votues për herë të parë, gratë, ku qëllimi është rritja e pjesëmarrjes së tyre në votime. Ky objektiv ka në fokus sensibilizimin e zgjedhësve gra, për të shmangur fenomenin negativ të votimit familjar në ushtrimin e të drejtës së tyre, për të votuar të lira dhe të pandikuara, votuesit për herë të parë, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje.

Pjesa e katërt: Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet, ku qëllimi kryesor është sensibilizimi i punonjësve të administratës shtetërore gjatë periudhës zgjedhore dhe informimi mbi shkeljet ligjore dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre, si dhe raportimi i cdo rasti në portalin e dedikuar për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve shtetërore, para zgjedhjeve

Pjesa e pestë: Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që zgjedhësi duhet të ndjekë në Qendrën e Votimit, si dhe procedurat e identifikimit elektronik në procesin e votimit, ku qëllimi është informimi për hapat që ndjek zgjedhësi në QV, së bashku me identifikimin elektronik të zgjedhësve që kryhet nga aparatura e identifikimit elektronik.

Pjesa e gjashtë: Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj. Zgjedhësit të jenë të përgatitur ditën e votimit për plotësimin e fletës së votimit që vota e tyre të jetë e vlefshme dhe informimin që ata votojnë vetëm për kryetarin e Bashkisë Himarë.

Sfidat e Programit

Sfidat kryesore të këtij programi janë realizimi brenda një kohe të shkurtër duke qenë se periudha që do të mbahen zgjedhjet është e shkurtër, dhe implementimi i plotë në të gjitha platformat e komunikimit i programit të edukimit. Aksesit që çdo zgjedhës i bashkisë Himarë të ketë në marrjen e informacionit të nevojshëm rreth procesit zgjedhor që do të mbahen në 4 gusht 2024.

Duke marrë në konsideratë afatet e ngushta kohore dhe konsensusin e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, zbatimi i këtij programi është sfidë për përmbushjen e misionit të KQZ-së.

Monika SINANI - Sektori i Informimit të Zgjedhësve
Ermina ALLUSHI- Drejtorja e Komunikimit dhe Koordinimit
Madalena KOJA- Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA- Sekretar i Përgjithshëm (Në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: . .2024

Nr:

Ora: 00:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE
NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETARIN E BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “g” dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Të miratoj programin për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Himarë, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: Nr: Ora:



“Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe sensibilizimit të zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e bashkisë Himarë